



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2770/2 prot.,

Datë 09.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TEA-D” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mallra” me nr. REF-79013-09-04-2023 me objekt: “Rikonstruksion Lulishtesh”, me fond limit 49,515,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.
- Ankimues:** “TEA-D” SHPK me NIPT K32522629L dhe adresë Gjirokastër, Libohovë, Rruga “Dhuvjan”, nr. pasurie 3105, ZK 2444.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit me adresë Rruga “5 Maji”, Tiranë.

Në datën 09.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3580 dhe me nr. 2770/2023 prot., datë 09.11.2023 e operatorit ekonomik “TEA-D” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “TEA-D” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”,

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “TEA-D” SHPK, si më poshtë vijon:

1.Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit , Pika 1.a sipas shtojcës 8, Në kundërshtim me kriterin 2.3.5 .d Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mësipërm, emër/mbiemër, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.

2.Operatori ekonomik nuk ka paraqitur . Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit Pika 1.b.

3.Operatori ekonomik Tea-D nuk plotëson kriterin 2.3.1 për paraqitjen për punë të ngjashme Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe prokurën e posaçme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;

4.Operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin 2.3.14 , procesverbali i paraqitur nuk është protokolluar pranë zyrave të DPPGJ.

5.Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat përpara zhvillimit të tenderit sipas procesverbalit të mbajtur në datë 13.10.2023 Prot., 1702/14.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 09.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro